



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P. 161/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.05.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Olta Shara” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF--46137-12-13-2019, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli” Elbasan*, me fond limit 81,401,951 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 17.02.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:** “Sori-Al” shpk  
Rruga “Beqir Luga”, Pallati nr.3, shk 1/1, Tiranë

**Autoriteti kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.  
Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 13.12.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF--46137-12-13-2019, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli” Elbasan*, me fond limit 81,401,951 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 17.02.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 17.02.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 03.03.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Nika	67,099,978	I skualifikuar
- Olta Shara	78,898,370	I kualifikuar
- Sori-AL	81,182,771.34	I kualifikuar
- KPL	81,231,173.98	I skualifikuar

II.4. Në datën 09.03.2020 operatori ekonomik “Sori-AL” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Bazuar në informacionin që disponojmë na rezulton se operatori ekonomik Olta Shara ka mangësi në dokumentacionin e dorëzuar si më poshtë:
- Referuar shtojcës 8 Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit të DT kërkohet dorëzimi i vetdeklarimit sipas përmbajtjes së shtojcës 7 kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit e cila kërkon që: Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë për Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik. Plotësimi i kësaj shtojce nuk është bërë konform kërkesave dhe ndryshimeve të fundit të LPP.
- Operatori ekonomik Olta Shara nuk ka dorëzuar sipas formës së kërkuar në DT : Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 1/1; Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas shtojcës 7/1; Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike sipas shtojcës 5. Deklaratë mbi konfliktin e interesit sipas shtojcës 6.
- Opeatori ekonomik Olta Shara nuk ka vërtetuar përmes vërtetimit të debisë së dorëzuar se ka shlyer detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë. Bazuar në të dhënat e QKB Olta Shara e ushtron aktivitetin e saj në adresat e mëposhtme: Lagja Haxhias Rruga Ismail Zyma Elbasan , Rruga Elbasan Librazhd Elbasan , Lagjia Luigj Gurakuqi Rruga 11 Nëntori Elbasan. Vërtetimi i dorëzuar nga ana e këtij operatori nuk legjitimon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike edhe për gjithë adresat e tjera sekondare ku ajo ushtron veprimtarinë e saj sic kërkohet në kriterin e përcaktuar në shkronjën (f) të seksionit 2 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DT.

- *Operatori ekonomik Olta Shara nuk plotëson kriterin për dorëzimin e certifikatave ISO 9001:2015, ISO 22000:2005, ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 të cilat duhet të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga RSH dhe për më tepër nuk janë të legalizuara apo me vulë apostile.*
- *Operatori ekonomik Olta Shara nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit për përvojë të suksesshme në ekzekutimin e shërbimeve të ngjashme në vlerë prej 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.*
- *Operatori ekonomik Olta Shara ka dështuar në dorëzimin e plotë ligjor të dokumentacionit për të vërtetuar se disponon ambjent gatimi sipas kërkesave të nënpikës 2 të pikës 3.3 kapaciteti teknik të DT. Licenca e kategorisë II.1.A.1 e paraqitur nga ana e ofertuesit nuk është lëshuar për ambjentin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe të gatimit të ushqimit por për një ambjent tjetër. Operatori gjithashtu nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar në shkronjën ( f) të nënpikës 2 të pikës 3.3. kapaciteti teknik të DT për plotësimin e standarteve tekniko –teknologjike për ambjentin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.*
- *Operatori ekonomik Olta Shara nuk disponon mjetin e transportit frigoriferik për transportin e produkteve ushqimore sipas kërkesave të nënpikës 3 të pikës 3.3 kapaciteti teknik të DT (Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose marrjen me qera, leja e qarkullimit, certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve , akt miratimi higjieno sanitar).*
- *Operatori ekonomik Olta Shara nuk plotëson numrin e të punësuarve të kërkuar në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar, punonjësit e paraqitur nga ofertuesi nuk figurojnë në listpagesën e shoqërisë për periudhën e kërkuar në DT. Ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për secilin nga punonjësit mercollog/kuzhinierë/ndihmës kuzhinierë sipas pikës 4.1 të kapacitetit teknik në DT (kontratë pune, librezë pune, librezë shëndetësore, diplomë ose certifikatë kualifikimi).*
- *Operatori ekonomik Olta Shara nuk ka dorëzuar deklaratën për disponimin ose mundësinë e disponimit të materialeve dhe mjeteve profesionale të domosdoshme /inventar i imët të kërkuara në shtojcën 9 të DT.*
- *Në DT shtojca 8 kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 6 është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se nga*

*kontrolli i fundit i realizuar nga AKU operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Nga ana e operatorit ekonomik nuk është dorëzuar kjo deklartaë.*

*Mungesa e këtyre elementëve thelbësore në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik Olta Shara duhej ti mjaftonte KVO për skualifikimin e këtij operatori.*

*Sa më sipër kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik Olta Shara.*

II.5. Me shkresën nr. 465/2 prot datë 17.03.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 25.03.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr.571/ prot datë 06.04.2020 protokolluar me tonën me nr.318/2 prot datë 14.04.2020 me objekt “*Informacion: është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.*

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjen me vend të sqarojë në rastin konkret, se megjithse ankesa e paraqitur paraqitet si një ankesë në total, KPP gjykon të marrë në shqyrtim të gjitha pretendimet e ngritura, për shkak të rëndësisë së objektit si dhe vlerës së konsiderueshme të tij ,me qëllim garantimin e ligjshmërisë dhe transparencës në procedurën e prokurimit objekt ankimi në përputhje me nenin 1 dhe 2 të LPP.

III.1.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Sori Al” shpk mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Olta Shara” P.F me argumentat *Referuar shtojcës 8 Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit të DT kërkohet dorëzimi i vetdeklarimit sipas përmbajtjes së shtojcës 7 kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit e cila kërkon që: Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë për Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.*

*Plotësimi i kësaj shtojce nuk është bërë konform kërkesave dhe ndryshimeve të fundit të LPP”, Operatori ekonomik Olta Shara nuk ka dorëzuar sipas formës së kërkuar në DT : Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 1/1; Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas shtojcës 7/1; Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike sipas shtojcës 5. Deklaratë mbi konfliktin e interesit sipas shtojcës 6”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Olta Shara” P.F dhe “Helios Gastronomi “ shpk kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë nëpërmjet Akt Marrëveshjes nr.820 datë 15.02.2020 *Për realizimin e sukseshëm të objektit Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore Xhafer Kongoli Elbasan.* Përqindja e kryerjes së furnizimeve do të jetë Olta Shara PF 40% dhe shoqëria Helios Gastronomi shpk 60% sipas sasisë të zërave të preventivit bashkëngjitur.

III.1.3. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë

*Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:*

- a) Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;*
- b) Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*
- c) Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d) Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*
- e) Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;*
- f) Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

III.1.4. Në shtojcën 7 ”Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme ” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

*Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.*

*Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilesinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në*

rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

• Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

• Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

(emër, atësi, mbiemër)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP<sup>1</sup>.

• Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

• Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi \_\_\_\_\_ aktiv).

• Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_

III.1.5 Në shtojcën modifikim mbi dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

\_\_\_\_\_

<sup>1</sup>Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

**I. Në Shtojcën nr.7 "Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme", në paragrafin e tretë,**

**ISHTE:**

- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

(emër, atësi, mbiemër)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

**BËHET:**

- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

	<b>Emër (Emrat)</b>	<b>Mbiemër</b>	<b>Datëlindje ditë muaj vit</b>	<b>Atësi</b>	<b>Amësi</b>	<b>Vendlindje</b>
1						
2						
3						

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

III.1.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE "Olta Shara" P.F& "Helios Gastronomi" shpk në përmbushje të kritereve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

"Olta Shara" P.F

- Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme
- Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur
- Deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike
- Deklaratë mbi konfliktin e interesave
- Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.



“Helios Gastronomi” shpk

- Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme
- Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur
- Deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike
- Deklaratë mbi konfliktin e interesave
- Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.

III.1.7. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.8. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.9. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se secili prej anëtarëve të bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë Olta Shara P.F & Helios Gastronomi shpk kanë dorëzuar deklaratat e kërkuara në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi në përputhje me formatin e përcaktuar për secilën prej tyre. Pretendimet e ngritura nga ankimuesi lidhur me mosplotësimin e deklaratave në formën e kërkuar rezultojnë të pabazuara.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sori Al” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Olta Shara” P.F me argumentat se “*Operatori ekonomik Olta Shara nuk ka vërtetuar përmes vërtetimit të debisë së dorëzuar se ka shlyer detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë. Bazuar në të dhënat e QKB Olta Shara e ushtron aktivitetin e saj në adresat e mëposhtme: Lagja Haxhias Rruga Ismail Zyma Elbasan , Rruga Elbasan Librazhd Elbasan , Lagjia Luigj Gurakuqi Rruga 11 Nëntori Elbasan. Vërtetimi i dorëzuar nga ana e këtij operatori nuk legjitimon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike edhe për gjithë adresat e tjera sekondare ku ajo ushtron veprimtarinë e saj sic kërkohet në kriterin e përcaktuar në shkronjën (f) të seksionit 2 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DT*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë

*Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:*

*g) Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër BOE “Olta Shara” P.F & “Helios Gastronomi” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

“Olta Shara” P.F

- Vërtetim Debie nr.3 prot datë 27.01.2020 me anë të së cilës vërtetohet se bazuar në deklaratimet e deklaruesit Olta Shara, vërtetohet se kërkuesja Olta Shara nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontrata me Kod XXXXX titullare e së cilës është Olta Shara rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datën 27.01.2020 përfshirë faturën koherente të muajit Dhjetor 2019.

“Helios Gastronomi” shpk

- Vërtetim Debie nr.1408/1 prot datë 31.01.2020 me anë të së cilës vërtetohet se bazuar në deklaratimet e deklaruesit A.K vërtetohet se kërkuesi Helios Gastronomi shpk nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontrata me Kod XXXXX titullar e së cilës është Helios Gastronomi rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datën 31.01.2020 përfshirë faturën koherente të muajit Dhjetor 2019.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.2.4 Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.2.5. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 4, gërma “ç” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , i ndryshuar parashikohet : *[...]Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”*

III.2.6. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*

III.2.7. Referuar korenspondencës mbajtur midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, nga kjo e fundit është konfirmuar se, pasi bëhen verifikimet përkatëse në sistemin e faturimit, lëshohet “Vërtetim Debit” sipas formatit standart për të gjitha subjektet aplikuese. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë elektrike, evidenton saktësinë e dokumentacionit, të paraqitur nga subjektet përkatëse si dhe tërësine e kontratave, dhe në fund konkludon me lëshimin e “Vërtetim Debit” i cili konfirmon se:

1. *Konsumatori nuk rezulton debitor në sistemin e furnizimit*
2. *Konsumatori rezulton debitor*

3. *Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur akt-marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.*

III.2.8. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.9. Referuar sa më sipër nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se anëtarët e bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë "Olta Shara" P.F& "Helios Gastronomi" shpk kanë dorëzuar vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike referuar datës së zhvillimit të procedurës, duke plotësuar kështu kriterin e vecantë të kualifikimit në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Sori AI" shpk për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik "Olta Shara" P.F me argumentat se "*Operatori ekonomik Olta Shara P.F nuk plotëson kriterin për dorëzimin e certifikatave ISO 9001-2015, ISO 22000:2005, ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 të cilat duhet të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga RSH dhe për më tepër nuk janë të legalizuara apo me vulë apostile*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 "Kriteret e vecanta të kualifikimit" pika 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*

2. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore sipas standardardit ndërkombëtar **ISO 22000**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*
3. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilesinë e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë në punë, sipas standardardit ndërkombëtar **ISO 18001** ose **ISO 45001**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*
4. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton sisteme të menaxhimit të mjedisit, sipas standardardit ndërkombëtar **ISO 14001**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE “Olta Shara” P.F & “Helios Gastronomi” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Olta Shara P.F

- EN-ISO 14001:2015 lëshuar nga AQSCERT
- EN-ISO 9001:2015 lëshuar nga AQSCERT
- EN-ISO 22000:2005 lëshuar nga AQSCERT
- BS OHSAS 18001:2007 lëshuar nga AQSCERT
- UNI 10854:99 H.A.C.C.P lëshuar nga AQSCERT

“Helios Gastronomi” shpk

- EN-ISO 9001:2015 lëshuar nga Certi W
- EN-ISO 22000:2005 lëshuar nga Certi W
- BS OHSAS 18001:2007 lëshuar nga Certi W
- EN-ISO 14001:2015 lëshuar nga Certi W
- UNI 10854:1999 lëshuar nga Certi W

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

Në nenin 46 pika 2 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se :*“[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.[...]”*

III.3.4. Në nenin 30 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet se:

*“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

III.3.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.3.6. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.7. Referuar sa më sipër nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se secili prej anëtarëve të bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Olta Shara” P.F& “Helios Gastronomi” shpk kanë dorëzuar certifikatat e cilësisë të kërkuara në kriterin e vecantë të kualifikimit të cilat janë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sori AI” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Olta Shara” me argumentat se “*Operatori ekonomik Olta Shara nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit për përvojë të suksesshme në ekzekutimin e shërbimeve të ngjashme në vlerë prej 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit. Realizimi i shërbimeve të ngjashme duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:*
  - *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes.*
  - *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të furnizuara.*

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE Olta Shara P.F & “Helios Gastronomi” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Akt Marrëveshje për Bashkimin e Përkohshëm të operatorëve ekonomikë Olta Shara P.F dhe Helios Gastronomi shpk Për realizimin e sukseshëm të objektit Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore Xhafer Kongoli Elbasan. Përqindja e kryerjes së furnizimeve do të jetë Olta Shara PF 40% dhe

shoqëria Helios Gastronomi shpk 60% sipas sasisë të zërave të preventivit bashkëngjitur.

#### Olta Shara P.F

- Vërtetim nr.74 prot datë 31.01.2020 lëshuar nga Spitali Psikiatrik Dr Sadik Dinci Elbasan me anë të së cilës vërtetohet se operatori ekonomik Olta Shara P.F në zbatim të kontratës lidhur me Spitali Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan me nr.15/28 dt 01.06.2016-04.12.2019 ka realizuar me sukses kontratën në masën 21,109,316 lekë e ndarë si vijon: Viti 2016-3,451,951, Viti 2017-5,902,230, Viti 2018-5,884,563, Viti 2019-5,870,572 lekë. Totali 21,109,316 lekë, shoqëruar me kontraten 15/28.
- Vërtetim nr.4/12 prot datë 04.12.2019 lëshuar nga Bashkia Elbasan me anë të së cilës vërtetohet se operatori Olta Shara ka qenë fitues në tenderin e zhvilluar në vitin 2017 nga Bashkia Elbasan me objekt “Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për nxënësit e shkollave të mesme profesionale duke lidhur kontratat më datë 22.09.2017 me afat deri 24.12.2020.Ky operator ka realizuar lëvrimin e shërbimit në vlerën prej 28,138,042 lekë në total deri në këtë periudhë sipas kërkesave të Bashkisë Elbasan.

#### “Helios Gastronomi” shpk

- Vërtetim Nr.73 prot datë 31.01.2020 ëshuar nga Spitali Psikiatrik Dr.Sadik Dinci Elbasan me anë të së cilës vërtetohet se operatori ekonomik Helios Gastronomi në zbatim të kontratës lidhur me spitalin psikiatrik Dr Sadik Dinci Elbasan me nr.15/28 prot datë 16.05.2016 me objekt Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për periudhën 01.06.2016-04-12-2019 ka realizuar me sukses kontratën në masën 163,454,554 e ndarë si më poshtë:  
Viti 2016-26,729,291 lekë  
Viti 2017-45,702,393 lekë  
Viti 2018-45,565,604 lekë  
Viti 2019-45,457,266 lekë  
Totali 163,454,554 lekë shoqëruar me kontraten 15/28

III.4.3. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

*“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....*

*2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së*



*punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.4.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.4.5. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 4, gërma “ç” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet : *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

*Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

III.4.6. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.4.7. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të paraqesin kontrata të ngjashme në vlerë totale prej jo më pak se 40 % e fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE Olta Shara P.F dhe Helios Gastronomi shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri nga secili prej anëtarëve të bashkimit është dorëzuar kontrata e lidhur me ent publikë së bashku me vërtetim realizimin ku dëshmohet se anëtarët e bashkimit plotësojnë kushtet ligjore lidhur me ngjashmërinë e furnizimeve të kryera, në një vlerë 40 % e fondit limit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Sori Al" shpk për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik "Olta Shara" P.F me argumentat se "*Operatori ekonomik Olta Shara ka dështuar në dorëzimin e plotë ligjor të dokumentacionit për të vërtetuar se disponon ambjentin sipas kërkesave të nënpikës 2 të pikës 3.3 kapaciteti teknik të DT. Licenca e kategorisë II.1.A.1 e paraqitur nga ana e ofertuesit nuk është lëshuar për ambjentin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe të gatimit të ushqimit por për një ambjent tjetër. Operatori gjithashtu nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar në shkronjën ( f) të nënpikës 2 të pikës 3.3. kapaciteti teknik të DT për plotësimin e standardeve tekniko –teknologjike për ambjentin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 8 "Kriteret e vecanta të kualifikimit" pika 3.3/2 "Kapaciteti teknik" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. *Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

a) Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ **Dokumentacioni që vërteton pronësinë:**

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;  
ose

- kontrata e shitblerjes;

ose

- kontrata e dhurimit;

ose

- çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ **Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:**

- Kontratë huaje.

➤ **Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:**

- Kontratë qiraje.

b) Licencën e kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

c) Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për zhvillimin e aktivitetit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, për këtë ambient.

d) Akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

e) Certifikate për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

f) Operatori ekonomik duhet të deklarojë plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.

III.5.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE Olta Shara P.F& “Helios Gastronomi” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Olta Shara P.F

- Kontratë Qiraje Nr.301 prot datë 01.06.2018 lidhur ndërmjet Spitali Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan dhe Shoqëria Olta Shara P.F me objekt Dhënia me qera e guzhinës së Spitalit Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan me sipërfaqe 195 m2 sipas planimetrisë bashkëlidhur kësaj kontrate që ndodhet në Spitalin Psikiatrik sadik Dinci Elbasan me kohëzgjatje 01.06.2018-31.05.2019.

- Licencë II.1.A (1) lëshuar nga QKB, për subjektin Olta Shara P.F me emërtim përshkrues të veprimtarisë Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (katering).
- Leje Mjedisore kategoria III.1A
- Akt Miratimi Higjeno Sanitar
- Certifikatë e mbrojtjes nga zjari dhe shpëtimi nr.09/1 datë 17.01.2019
- Kontratë Qeraje nr.390 prot datë 31.05.2019 lidhur ndërmjet Spitali Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan dhe Shoqëria Olta Shara P.F me objekt Dhënia me qera e guzhinës së Spitalit Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan me sipërfaqe 195 m2 sipas planimetrisë bashkëlidhur kësaj kontrate që ndodhet në Spitalin Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan me kohëzgjatje 01.06.2019-31.12.2019.
- Kontratë Qeraje Nr.792 prot datë 13.12.2019 lidhur ndërmjet Spitali Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan dhe Shoqëria Olta Shara P.F me objekt Dhënia me qera e guzhinës së Spitalit Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan me sipërfaqe 195 m2 sipas planimetrisë bashkëlidhur kësaj kontrate që ndodhet në Spitalin Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan me kohëzgjatje 01.01.2020-31.12.2020.
- Deklaratë Për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për ambjentin ku deklarohet se Olta Shara P.F plotëson standartet tekniko teknologjike për ambjentin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.

#### “Helios Gastronimi” shpk

- Kontratë Qeraje Nr.2176 Rep Nr.559 Kol datë 25.04.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomi shpk në cilësinë e qeramarrësit dhe S.XH dhe F.XH në cilësinë e qeradhënësit me objekt Truall me sipërfaqe 1437 m2 dhe Ndërtesë me sipërfaqe 575.20 m2, i ndosur në Sharë Tiranë, i rregjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë vërtetuar sipas certifikatës për vërtetim pronësie datë 07.01.2016 lëshuar nga ZRPP Tiranë. Afati i kontratës 8 vjet e 11 muaj.
- Certifikatë për Vërtetim Pronësie
- Licencë lëshuar nga QKL me Kod II.1.A (1) subjektit Helios Gastronomi me emërtim përshkrues të veprimtarisë Restorant Katering
- Leje Mjedisore lëshuar nga QKL me Kod III.1.A subjektit Helios Gastronomi me emërtim përshkrues të veprimtarisë Leje mjedisore e tipit C për gatim dhe tregëtimin e produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme.
- Akt Miratimi Higjeno Sanitar Nr.1099
- Akt Miratimi Higjeno Sanitar Nr.2187
- Certifikatë e mbrojtjes nga zjari dhe shpëtimi nr.H-2462/1 datë 03.02.2020
- Deklaratë Për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për ambjentin ku deklarohet se Helios Gastronomi shpk plotëson standartet tekniko teknologjike për ambjentin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*  
b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.5.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.5.5. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.5.6. Referuar sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se anëtarët e bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë Olta Shara P.F& Helios Gastronomi shpk me dokumentacionin e dorëzuar dëshmojnë se disponojnë një ambient ku ushtrojnë veprimtarine e shërbimit dhe gatimit të ushqimit sipas kërkesave në kriterin e vecantë të kualifikimit. KPP vëren se anëtarët e bashkimit kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit konkretisht Licencën e kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për zhvillimin e aktivitetit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, për këtë ambient, Akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, Certificate për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, deklaratë për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarine e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Sori Al” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Olta Shara” P.F me argumentat se “*Operatori ekonomik Olta Shara nuk disponon mjetin e transportit frigoriferik për transportin e produkteve ushqimore sipas kërkesave të nënpikës 3 të pikës 3.3 kapaciteti teknik të DT (Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose marrjen me qera, leja e qarkullimit, certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve , akt miratimi higjieno sanitar)*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 3.3/3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

3. *Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi, huapërdorje ose me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës, si më poshtë:*

➤ ***Dokumentacioni që vërteton pronësinë:***

- *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;*  
ose

- *kontrata e shitblerjes;*

ose

- *kontrata e dhurimit;*

ose

- *çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

➤ ***Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:***

- *Kontratë qiraje.*
- a) *leje qarkullimi,*
- b) *certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,*
- c) *policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,*
- d) *akt miratimi higjeno – sanitar.*

III.6.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër BOE “Olta Shara” P.F & “Helios Gastronomi” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

“Olta Shara” P.F

- *Certifikatë e Pronësisë së Mjetit Rrugor me targa AA081PV në emër të Olta Shara P.F, Leje Qarkullimi, Certifikatë e Kontrollit Teknik të Mjetit Rrugor, Policë Sigurimi, Akt Miratimi Higjeno Sanitar Nr.29 .*

“Helios Gastronomi” shpk

- *Kontratë Qeraje Nr.533 Rep Nr.339 Kol datë 03.02.2020 lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqëria Helios Gastronomi shpk në cilësinë e qeramrresit me objekt dhënia me qera e mjetit lloji ATV me targa AA084XE , Leje Qarkullimi, Certifikatë e Pronësisë së Mjetit Rrugor, Certifikatë e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugor, Policë Sigurimi, Akt Miratimi Higjeno Sanitar Nr.53*

III.6.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*  
 b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.6.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.6.5. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.6.6. Referuar sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se secili prej anëtarëve të bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë Olta Shara P.F& Helios Gastronomi shpk kanë dorëzuar dokumentacion për provueshmërinë e disponimit të një mjeti frigoriferik për transportin e produkteve ushqimore. KPP gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar anëtarët e bashkimit dëshmojnë se disponojnë (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi, huapërdorje ose me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës në përputhje me kriterin e vecantë të kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Sori Al” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Olta Shara” P.F me argumentat se *“Operatori ekonomik Olta Shara nuk plotëson numrin e të punësuarve të kërkuar në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar, punonjësit e paraqitur nga ofertuesi nuk*



figurojnë në listpagesën e shoqërisë për periudhën e kërkuar në DT. Ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për secilin nga punonjësit mercollog/kuzhinier/ndihmës kuzhinier sipas pikës 4.1 të kapacitetit teknik në DT (kontratë pune, librezë pune, librezë shëndetësore, diplomë ose certifikatë kualifikimi)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit pika 3.3/4 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

4. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 20 (njëzetë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Qershor 2019 – Nëntor 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Qershor 2019 – Nëntor 2019.
- Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Qershor 2019 – Nëntor 2019.

4.1 Punonjësit e punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kuzhinier	3
2	Mercollog/Kimist/teknolog	1
3	Ndihmes kuzhinier/Shërbyes gatimi	15
4	Shofer	1
	<b>Total</b>	<b>20</b>

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Për kuzhinierin: diplome ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libeze pune, librezë shëndetsore.
- b) Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libeze pune, librezë shëndetsore.
- c) Për ndihmës kuzhinier/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes, librezë shëndetsore.
- d) Për shoferin: kontratë pune, librezë pune dhe leje drejtimi mjeteve kategorisë – B.
- e) Punonjësit me profesionet e mësipërme duhet të figurojnë në listpagesat e operatorit ekonomik për periudhën e kërkuar.

III.7.2. Në shtojcën modifikim mbi dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si me poshtë:

Tek Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”:

**Tek pika 3.3, Kapaciteti teknik, nënpika 4:**

**ISHTE:**

4. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 20 (njëzetë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Qershor 2019 – Nëntor 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019.
- Listëpagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019.

**BËHET:**

4. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 20 (njëzetë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019.
- Listëpagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019.

III.7.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër BOE “Olta Shara” P.F& “Helios Gastronomi” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Akt Marrëveshje për Bashkimin e Përkohshëm të operatorëve ekonomikë Olta Shara P.F dhe Helios Gastronomi shpk Për realizimin e sukseshëm të objektit Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore Xhafer Kongoli Elbasan. Përqindja e kryerjes së furnizimeve do të jetë Olta Shara PF 40% dhe shoqëria Helios Gastronomi shpk 60% sipas sasisë të zërave të preventivit bashkëngjitur.

Olta Shara P.F

- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe A.D në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e kuzhinierit, Certifikatë për përfundimin e kursit profesional të kuzhinës , Librezë Pune., Librezë shëndetësore
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë punëdhënëses dhe L.D në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin Kuzhinier, Certifikatë për përfundimin e kursit 9 mujor për kuzhinë, Librezë Pune., Librezë shëndetësore, Librezë higjeno sanitare.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe I.M në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e Mercologe Kimiste, Librezë Pune, Diplomë, Librezë shëndetësore.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe A.K në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Shofer, Librezë Pune, Leje drejtimi, Librezë shëndetësore.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe Dh.L në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e ndihmës Guzhiniere/shërbyese gatimi, Librezë Pune, Librezë shëndetësore.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe K.F në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e ndihmës kuzhinere/shërbyese gatimi, Librezë Pune, Librezë shëndetësore.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe V.D në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e ndihmës kuzhinere/shërbyese gatimi, Librezë pune, Librezë shëndetësore,
- Kontratë Individuale pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe F.S në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe T.G në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore,
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe A.M në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e ndihmës kuzhinere, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore,
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe B.M në cilësinë e punëmarrëse në pozicionin e ndihmës kuzhinere/shërbyes gatimi, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore,
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe J.F në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, Librezë Pune, Librezë shëndetësore,
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe M.H në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, Librezë pune, Librezë shëndetësore,

- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe M.A në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, Librezë pune, Librezë shëndetësore,
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe P.C në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e ndihmës guzhinere, Librezë pune, Librezë shëndetësore,
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Olta Shara P.F në cilësinë e punëdhënëses dhe M.K në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e ndihmës kuzhinier dhe kuzhinier, Librezë pune, Librezë shëndetësore,
- Listpagesa Tetor 2018-Dhjetor 2019.
- Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore
- Listpagesa Qershor 2019- Dhjetor 2019

“Helios Gastronomi” shpk

- Kontratë Individuale Pune datë 11.09.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe M.L në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin kuzhinier, Raport Mjeko Ligjor, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore, Certifikatë lëshuar nga subjekti privat i formimit profesional Vitrina.
- Kontratë Individuale e Punës datë 12.09.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe V.M në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin kuzhinier, Librezë Pune, Raport i Aftësisë në Punë, Librezë Shëndetësore, Certifikatë formimi profesional.
- Kontratë Individuale e Punës datë 13.09.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe H.XH në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Shofer, Librezë Pune, Leje Drejtimi.
- Kontratë Individuale e Punës datë 04.04.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe F.Z në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Kuzhinier, Librezë Pune, Raport Mjeko Ligjor, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale e Punës datë 12.09.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe A.S në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Nd/kuzhinier, Librezë Pune, Librezë shëndetësore, Raporti i Aftësisë në Punë.
- Kontratë Individuale e Punës datë 03.12.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe E.M në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Nd/Kuzhinier, Librezë Shëndetësore, Librezë Punë.
- Kontratë Individuale e Punës datë 03.12.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe F.C në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Nd/Kuzhinier, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale e Punës datë 01.12.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe F.M në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Nd/Kuzhinier, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.

- Kontratë Individuale e Punës datë 08.12.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe L.GJ në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Nd/kuzhinier, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale e Punës datë 01.07.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe M.Sh në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Nd/kuzhinier, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale e Punës datë 27.06.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe M.H në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Nd/kuzhinier, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale e Punës datë 03.07.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe V.O në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Nd/Kuzhinier, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale e Punës datë 23.09.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe M.F në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Nd/Kuzhinier, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale e Punës datë 09.10.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe A.L në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Kuzhinier/Shërbyes ushqimi, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale e Punës datë 15.09.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe D.I në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Kuzhinier /shërbyes ushqimi, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale e Punës datë 11.09.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe I.K në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Kuzhinier/shërbyes ushqimi, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale e Punës datë 27.09.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe M.Sh në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Kuzhinier/shërbyes ushqimi, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Kontratë Individuale e Punës datë 01.01.2020 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe S. GJ në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Teknolog/Specialist i cilësisë dhe sigurisë ushqimore, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore, Dëftesë Pjekurie.
- Kontratë Individuale e Punës datë 01.09.2019 lidhur ndërmjet Helios Gastronomik shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe R.B në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Nd/Kuzhinier, Librezë Pune, Librezë Shëndetësore.
- Vërtetim Nr.T01774214 datë 30.01.2020 Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore
- Listpagesat e kontributeve shoqërore , shëndetësore dhe taimit mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën Tetor 2019-Dhjetor 2019

III.7.4. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.7.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.7.6 Neni 28, pika 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : “5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV të tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose*

*c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.7.7. Komisioni i Prokurimit Publik referuar bazës ligjore të sipërcituar gjykon se përmbushja e kriterëve duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen e marrë përsipër për realizimin me sukses të kontratës. Komisioni referuar dokumentacionit sa më sipër të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me numrin mesatar të punonjësve konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Olta Shara” P.F referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër kryerjen e 40 % të volumit të kontratës. Ndërsa anëtari tjetër i bashkimit Helios Gastronomi shpk ka marrë përsipër realizimin e 60 % të volumit të kontratës.

Nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar disponimi nga ana e operatorëve ekonomikë të një stafi prej 20 personash nga të cilët 3 kuzhiner, 1 mercollog/kimist teknolog, 15 ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, 1 shofer.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga të dy anëtarët e bashkimit të përkohëshëm të operatoreve ekonomikë rezulton se disponojnë në stafin e tyre punonjës me kualifikimet e kërkuara në kriterin e vecantë të kualifikimit në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se anëtarët e bashkimit të përkohëshëm të shoqërive janë në kushtet e përmbushjes së kriterit të vecantë të kualifikimit lidhur me numrin e punonjësve.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë Olta Shara P.F dhe Helios Gastronomi shpk është në përputhje me

kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kriteri për disponimin e stafit të nevojshëm për realizimin e kontratës është plotësuar nga të dy anëtarët e bashkimit në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sori AI” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik Olta Shara P.F me argumentat se *“Operatori ekonomik Olta Shara nuk ka dorëzuar deklaratën për disponimin ose mundësinë e disponimit të materialeve dhe mjeteve profesionale të domosdoshme /inventar i imët të kërkuara në shtojcën 9 të DT”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.8.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit pika 3.3/5 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- *Operatori ekonomik duhet të deklarojë disponimin ose mundësinë e disponimit të materialeve dhe mjeteve profesionale të domosdoshme/inventari i imët, të kërkuara në shtojcën 9 te DT.*

III.8.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE Olta Shara P.F& “Helios Gastronomi” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

“Olta Shara” P.F

- Deklaratë për disponimin e materialeve dhe mjeteve profesionale me anë të së cilës deklarohet se Olta Shara P.F disponon materialet dhe mjeteve profesionale të domosdoshme/inventari i imët të kërkuar në shtojcën 9 të DT.

“Helios Gastronomi” shpk

- Deklaratë për disponimin e materialeve dhe mjeteve profesionale me anë të së cilës deklarohet se Helios Gastronomi shpk disponon materialet dhe mjeteve profesionale të domosdoshme/inventari i imët të kërkuar në shtojcën 9 të DT.

III.8.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*



Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.8.4. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.8.5. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se secili prej anëtarëve të bashkimit të përkohëshëm të operatorëve ekonomikë Olta Shara P.F& Helios Gastronomi shpk kanë dorëzuar deklaratën e kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sori Al” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Olta Shara” P.F me argumentat se *Në DT shtojca 8 kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 6 është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga AKU operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Nga ana e operatorit ekonomik nuk është dorëzuar kjo deklaratë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.9.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit pika 3.3/6 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.*

III.9.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE Olta Shara P.F & “Helios Gastronomi” shpk në përmbushje të kriterit sa më lart ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

“Olta Shara” P.F

- Deklaratë për kontrollin e fundit të realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me anë të së cilës deklarohet se Olta Shara P.F nga kontrolli i fundit të realizuar nga AKU operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

“Helios Gastronomi” shpk

- Deklaratë për kontrollin e fundit të realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me anë të së cilës deklarohet se Helios Gastronomi shpk nga kontrolli i fundit të realizuar nga AKU operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

III.9.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.9.4. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.9.5. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se secili prej anëtarëve të bashkimit të përkohëshëm të operatorëve ekonomikë Olta Shara P.F& Helios Gastronomi shpk kanë dorëzuar deklaratën e kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sori Al” shpk për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF--46137-12-13-2019, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli” Elbasan*, me fond limit 81,401,951 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 17.02.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 318 Protokoli; Datë 25.03.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**

